

## NDËRTIMI I QËNDRUESHMËRISË KLIMATIKE TË PYJEVE PËRMES PËRSHTATJES SË BAZUAR NË EKOSISTEM (EBA)

### Konteksti

Ndërtimi i qëndrueshmërisë klimatike të pyjeve përmes përshtatjes së bazuar në ekosistem (EbA) është një projekt afatshkurtër që synon të forcojë qëndrueshmërinë klimatike të pyjeve në Bashkinë e Elbasanit, duke përmirësuar rrjedhimisht mirëqënien e banorëve të zonës, si dhe duke bërë më të mundur përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Projekti përbëhet nga katër komponentë: 1) Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe teknike për përshtatjen e bazuar në ekosistem në Elbasan; 2) Hulumtimi mbi EbA-n dhe rëndësinë e klimës në jetëse; 3) Ndërgjegjësimi i qytetarëve të Bashkisë Elbasan; 4) Zbatimi i një ndërhyrjeje të vogël EbA në Bashkinë e Elbasanit, përgjatë lumit Shkumbin, me qëllim zbutjen e përmbytjeve.



### Objektivat e projektit

Objektivat specifikë të projektit janë:

- i) Rritja e kapaciteteve teknike dhe institucionale për të integruar EbA-n në planet ekzistuese të menaxhimit;
- ii) Identifikimi dhe zbatimi i masave të EbA-s në pyllin e degraduar në Bashkinë e Elbasanit për të rivendosur zonat pyjore të degraduara dhe për të reduktuar cenueshmërinë e komuniteteve vendase ndaj ndryshimeve klimatike;
- iii) Rritja e ndërgjegjësitimit dhe njohurive të qytetarëve mbi përfitimet e EbA-s për rritjen e qëndrueshmërisë së ekosistemeve dhe përmirësimin e mirëqënies së tyre.

### Produktet

- 200 pemë të mbjella në Bashkinë Elbasan si pjesë e ndërhyrjes së EBA-së në shkallë të vogël;
- 20 zyrtarë të pushtetit vendor, duke përfshirë zyrtarë nga Drejtoria e pyjeve, trajnohen për integrimin e EbA-s dhe përfshirjen e ndërhyrjeve të EbA-s në planifikimin vendor;
- 100 qytetarë dhe banorë të zonës së synuar fitojnë njohuri dhe ndërgjegjësim mbi përfitimet e zbatimit të EBA-së në komunën e tyre.

#### INFORMACION I PËRGJITHSHËM

##### DONATORI:

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)

##### PARTNERËT:

• Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU)

##### KOHËZGJATJA:

/15/31/2021 - 15/06/2022

##### KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv  
Instituti i Kërkimeve Urbane  
Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,  
Ap. 56 Tiranë, Shqipëri

M: +355694333808

E : zvokopola@uri.org.al

### Rreth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llobojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.

